

QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT
Nr. 17890 Prot.
Datë 01.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE

Nr. 4381 Prot.

Dt. 30.6.2022

L E N D A: Dergohet per ekzekutim vendimi penal i Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane.

Drejtuar: DREJTORIA VENDORE E POLICISE TIRANE,
TIRANE

QENDRES KOMBETARE TE BIZNESIT
TIRANE

DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE TATIMEVE
TIRANE

ZYRA PERMBARIMORE
TIRANE

Per dijeni: GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Drejtuar: "IM DATA", shpk & Paolo Palumbo,
Rr. Islam Alla pall. Ivea kati.1, Tirane
"Media Future" shpk & Rosario Lazzarin
Kashar- Mezez, Autostrada Tirane Durres, Qendra Pajtoni
Bussines Center, Tirane
"SOFTLOG" shpk & Salvatore Solazzo
Rr. Rr. Ismail Qemali nd.22, h.4, ap.23, Tirane

Drejtuar: Av. Rabije Cenalia, Gezime Buci, Edvis Gorishti
DHOMA E AVOKATISE
TIRANE

Bashkelidhur me kete shkrese dergojme urdherin per ekzekutim dhe vendimin penal me nr. 874, date 04.04.2022 te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane.
Te merren masat ligjore per ekzekutimin e vendimit.
Duke ju falenderuar per mirekuptimin dhe bashkepunimin.

DREJTUESI I PROKURORISË
ARENS ÇELA
ME URDHER DHE DELEGIM
DREJTUESI I SEKSIONIT
YLLI BASHAI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE

U R D H E R

“PER EKZEKUTIMIN E VENDIMIT PENAL”

Ne Tirane, me 27.06.2022,

Une Endrit Bimi, Prokuror ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Tirane,
pasi studiova vendimin penal te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr. 874,
date 04.04.2022,

K O N S T A T O V A

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin e saj penal nr.874, date 04.04.2022, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor te te pandehurve **Paolo Palumbo, Rosario Lazzarin dhe Salvatore Solazzo** per vepren penale “Fshehja e te ardhurave”, parashikuar nga neni 180/3 I K. P, denimin e tyre me nga 5 vjet burgim,
- Vuajtja e denimit fillon nga dita e ekzekutimit te vendimit dhe do te vuhet ne nje burg te sigurise se zakonshme
- Deklarimin fajtor te te pandehurve “**IM DATA**”, **shpk**, “**Media Future**” **shpk**, “**SOFTLOG**” **shpk** per vepren penale “Fshehja e te ardhurave”, parashikuar nga neni 180/3 I K. P, denimin e tyre me mbarimin e personit juridik
- Shpenzimet ne vleren 80350 leke ne ngarkim te te pandehurve

Vendimi ka marre forme te prere me 20.06.2022 pasi nuk eshte ankimuar.

Per sa siper dhe ne mbeshtetje te neneve 462-464 e vijues te K.Pr.Penale dhe ne ligjin nr.79/2020 “Per ekzekutimin e vendimeve penale” ,

U R D H E R O J

1. Ekzekutimin e vendimit penal nr. 874, date 04.04.2022 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per te denuarit e mesiperm.
2. Me zbatimin e ketij urdheri ngarkohet Drejtoria Vendore e Policise Tirane dhe Zyra Permbarimore Tirane Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe QKB, ne Tirane.
3. Ky urdher iu njoftua, te denuarve si dhe Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane qe ka dhene vendimin.
4. Pas perfundimit te ekzekutimit, te njoftohet sipas ligjit Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane.
5. Bashkelidhur ju dergojme nje kopje te vendimit penal nr. 874, date 04.04.2022 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

PROKUROR
ENDRIT BIM I



REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 2433/227 Rregj. Them

Nr. 874 Vendimi

Data rregj.02.06.2021

Data vendimit 04.04.2022

VENDIM



NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Gjyqtar: LAZER SALLAKU

Asistuar nga sekretari gjyqësor **Rei Peçi**, me pjesmarrjen e prokurtores **Anisa Qilimi**, sot me dt. 04.04.2022, në Tiranë, mori në shqyrtim ne seancë gjyqësore publike çështjen penale, qe i perket:

- I PANDEHUR:** **Paolo Palumbo**, i dtl.13.07.1998, lindur në Itali, identifikuar me ID-AY4352912, gjykuar ne mungese pasi ndodhet jashtë shtetit, mbrojtur nga avokate Rabije Cenalia, caktuar kryesisht nga gjykata.
- I PANDEHUR:** **Subjekti Juridik "IM DATA" sh.p.k.**, me Nr. NUIS L81630006H, me seli ne adresen Tiranë, njesia bashkiake nr.10, rruga "Islam Alla", pallati IVEA, kati 1, me administrator **Paolo Palumbo**, gjykuar ne mungese, mbrojtur nga avokate Rabije Cenalia, caktuar kryesisht nga gjykata.
- I PANDEHUR:** **Salvatore Solazzo**, i dtl.01.05.1993, lindur në Itali, identifikuar me ID-AY4352882, gjykuar ne mungese pasi ndodhet jashtë shtetit, mbrojtur nga avokate Gezime Buci, caktuar kryesisht nga gjykata.
- I PANDEHUR:** **Subjekti Juridik "SOFT LOG" sh.p.k.**, me Nr. NUIS L811904031F me seli ne adresen Tiranë, njesia administrative nr.5, rruga "Ismail Qemali", nd.22, hyrja 4, ap.23, me administrator **Salvatore Solazzo**, gjykuar ne mungese, mbrojtur nga avokate Gezime Buci, caktuar kryesisht nga gjykata.
- I PANDEHUR:** **Rosario Lazzarin**, i dtl.27.10.1978, lindur në Itali, identifikuar me ID-AT4610426, gjykuar ne mungese pasi ndodhet jashtë shtetit, mbrojtur nga avokat Edvis Gorishti, caktuar kryesisht nga gjykata.
- I PANDEHUR:** **Subjekti Juridik "Media Future" sh.p.k.**, me Nr. NUIS L91521009H me seli ne adresen Tiranë, Kashar Mezez, lagjia Fushe Mezez, autostrada Tirane-Durres km 1, Qendra Pajtoni Bussines Center, me administrator **Rosario Lazzarin**, gjykuar ne mungese, mbrojtur nga avokat Edvis Gorishti, caktuar kryesisht nga gjykata.



AKUZUAR: Per kryerjen e veprës penale “**Fshehje e te ardhurave**”, parashikuar nga neni 180/3 i Kodit Penal.

Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen me gjykim të zakonshëm, dëgjoi Prokurorin e çështjes, në diskutimet perfundimtare kerkoi:

Deklarimin fajtor te te pandehurit Paolo Palumbo akuzuar per veprën penale “Fshehje e te ardhurave” parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal dhe denimin e tij me 5 vjet burgim.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Salvatore Solazzo akuzuar per veprën penale “Fshehje e te ardhurave” parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal dhe denimin e tij me 5 vjet burgim.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Rosario Lazzarin akuzuar per veprën penale “Fshehje e te ardhurave” parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal dhe denimin e tij me 5 vjet burgim.

Deklarimin fajtor te te pandehurit personit juridik shoqeria “Media Future” sh.p.k., me NIPT L91521009H i akuzuar per veprat penale “Fshehje e te ardhurave” parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal dhe ne baze te nenit 29 e 43 te K.Penal si dhe nenit 9 pika 1 germa “b” te ligjit Nr. 9754, date 14.06.2007 “Per pergjесine penale te personave juridik” aplikimin e denimit kryesor, mbarimin e personit juridik.

Deklarimin fajtor te te pandehurit personit juridik shoqeria “Soft Log” sh.p.k., me NIPT L811904031F i akuzuar per veprat penale “Fshehje e te ardhurave” parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal dhe ne baze te nenit 29 e 43 te K.Penal si dhe nenit 9 pika 1 germa “b” te ligjit Nr. 9754, date 14.06.2007 “Per pergjесine penale te personave juridik” aplikimin e denimit kryesor, mbarimin e personit juridik.

Deklarimin fajtor te te pandehurit personit juridik shoqeria “Im Data” sh.p.k., me NIPT L81630006H i akuzuar per veprat penale “Fshehje e te ardhurave” parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal dhe ne baze te nenit 29 e 43 te K.Penal si dhe nenit 9 pika 1 germa “b” te ligjit Nr. 9754, date 14.06.2007 “Per pergjесine penale te personave juridik” aplikimin e denimit kryesor, mbarimin e personit juridik..

Avokaten Rabije Cenalia e cila deklaroi: Shpalljen e te pafajshem te te pandehurit Paolo Palumbo dhe personit juridik subjektit “Im Data” sh.p.k., per kryerjen e veprës penale “Fshehje e te ardhurave”, te parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal, pasi nuk provohet qe i pandehuri dhe personi juridik te kene kryer veprën penale, sipas neni 388/d te K.Pr.Penale.

Avokaten Gezime Buci e cila deklaroi: Shpalljen e te pafajshem te te pandehurit Salvatore Solazzo dhe subjektit “Soft Log sh.p.k.” te akuzuar per veprën penale te “Fshehja e te ardhurave” parashikuar nga neni 180/3 i k.Penal, pasi akuza ne ngarkim te tyre nuk provohet tej cdo dyshimi te arsyeshem.

Avokatin Edvis Gorishti i cila deklaroi: I kerkoj gjykates pafajsi per te pandehurit, per akuzen “Fshehje e te ardhurave”, parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal.

Gjykata, pasi shqyrtoj çështjen në tërësi:

VEREN

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka sjellë për gjykim çështjen penale në ngarkim të pandehurve **Paolo Palumbo, Rosario Lazzarin, Salvatore Solazzo dhe subjektet juridike “IM DATA” sh.p.k., “Media Future” sh.p.k., “SOFTLOG” sh.p.k.**, akuzuar per veprën penale të “**Fshehja e te ardhurave**”, parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur per gjykim bazuar ne nenin 69 te K.Pr.Penale, çmoi se çështja eshte ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kesaj çështje penale

duhet te realizohet perpara kesaj gjykate.

Po keshtu kjo ceshtje ne baze te neneve 13 dhe 74 te K.Pr.Penale, eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate, pasi vepra penale per te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet me trup gjykues te perbere nga nje gjyqtar.

Persa i perket kompetences tokesore, ajo percaktohet shprehimisht ne nenin 76 te K.Pr.Penale ku citohet se: *"Kompetenca tokesore percaktohet, me rradhe, nga vendi ku eshte kryer ose tentohet te kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja"*. Persa me siper, perderisa vepra penale dyshohet se eshte kryer ne Tiranë, kompetente per nga territori eshte kjo gjykate.

Gjithashtu, Gjykata ne veshtrim te neneve 13,15,16,17,18 te K.Pr.Penale, çmoi se nuk ekzistojne shkaqe papajtuesmerie ose perjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundershtuar edhe nga palet pasi u prezantua perberja e trupit gjykues.

Gjykata konstaton se, në zbatim të nenit 332/c pika 3 të K.Pr.Penale nën titullin "Zhvillimi i seancës" të pandehurit nuk kanë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar, pasi kanë rezultuar jashtë shtetit dhe gjykata ka vazhduar në mungesë të të pandehurve.

Rrethanat e faktit.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoi se mbi bazën e referimit të bërë nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr.9476 të vitit 2019, për veprat penale **"Fshehjes së të ardhurave"** parashikuar nga neni 180/3 i Kodit Penal.


Nga ana e Seksionit Kundër Pastrimit të Parave, pranë Drejtorisë së Policisë Qarkut Tiranë, është grumbulluar informacion për një rast të dyshuar për pastrim të produkteve të veprës penale. Nga Informacioni grumbulluar dhe verifikimet e kryera në rrugë operative ka rezultuar se në lidhje me subjektin "Media Future" shpk, me Nipt L91521009H, ka patur transferta në mbërritje dhe me anomali.

Referuar ekstraktit të QKB-se Subjekti Media Future mban data e regjistrimit 21.03.2019, emri i subjektit MEDIA FUTURE, Forma ligjore SHPK, Data e themelimit 18.03.2019, Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri, ne adresen Tirane Kashar MEZEZ Lagjja Fushe Mezez, Autostrada Tirane-Durres, Km 1, Qendra Pajtoni Bussines Center, Kati 2, me nje kapital 10.000,00, Objekti i aktivitetit Ofrimi i sherbimeve call center dhe te kontaktit telefonik ne pergjithesi edhe nepermjet marrjes dhe kalimit te telefonatave, e gjitha si per llogari te saj edhe per llogari te te treteve. Menaxhimi dhe prodhimi i fushatave te reklamave dhe marketingut. Marketimin e produkteve dhe sherbimeve ne sektorin informatik. Telemarketing outbound per kompani mbi porosi te jashtme, me aksioner dhe Administrator shtetasin Italian Rosario Lazzarin me ID AT4610426, i dtl 27.10.1978. Ky subjekt vazhdon te jete aktiv edhe sot.

Policia gjyqësore ka relatuar se, dyshimet që lindin nga anomali të e specifikuar janë si më poshtë:

Për subjektin "Media Future" shpk, ka raportime bankare pranë Bankës Intesa San Paolo Bank, se gjatë muajit Korrik në llogarinë e subjektit kanë mbërritur disa transferta nga Nigeria. Dërguesit e transfertave janë kompanitë Vogue eeb Solution dhe Flutter eave Technology Solutions.

Nga verifikimi në C@TS, në shoqërinë Future Media shpk, përmendet si i punësuar në disa deklarata vetëm shtetasi Rosario Lazzarin, duke ngritur dyshime mbi pretendimet se kjo shoqëri kishte rreth 40 punonjës të punësuar.



Në material raportohet gjithashtu se në datën 09.01.2020, ka mbërritur në favor të subjektit Media Future një transfer të vlerën 14.490 euro. Derguesi i transferes është subjekti Vogue Eeb Solution Limited. Për këtë transfer të dokumentacionit justifikues është paraqitur një faturë që mban datën 16.01.2020 me detajet "Saas Marketing". Lidhur me këtë transfer të DPPPP, pranë Ministrisë së Financave ka nxjerrë urdhërin nr 06 datë 23.01.2010, për bllokimin e përkohëshëm të llogarive të subjektit Media Future shpk, pranë Bankës Intesa San Paolo Albania.

Sipas dokumentacionit të depozituar, pagesat janë për fushatë marketingu nëpërmjet internetit. Nga analiza e transaksioneve në llogarinë e subjektit rezulton se janë kredituar gjithsej 35 transfera me një vlerë totale në Euro 427,182. Në mënyrë të detajuar, transferat sipas kompanive dërguese janë si më poshtë:

Moorëand shpk- Eur 377,250 nga Belgjika.

Vogue Eeb Solution- Eur 34,955 nga Nigeria.

FlutterEave Technology Solutions- Eur 14,977 nga Nigeria.

Në lidhje me transferat nga Belgjika është paraqitur një marrëveshje marketingu, e ngjashme me marrëveshjet e tjera që ka me kompanitë nga Nigeria. Qëllimi i transferave është për pagesa komisioni.

Në lidhje me përdorimin e shumave, rezulton se janë tërhequr në "cash", për shpenzime biznesi, nga firma e autorizuar në llogarinë e klientit, që është shtetasi Ismail Mici. Shumat tërhiqen për shpenzime biznesi dhe pagat e punonjësve. Shoqëria deklarohet të ketë 40 punonjës.

Nga analiza e llogarive, nuk vihen re pagesa punonjësish ose shlyerje detyrimesh ndaj shtetit.

Shtetasi Ismail Mici, ka rezultuar i përmendur në rastin e referuar pranë DPPSH me anë të shkresës nr.598/2 prot., datë 09.08.2019, si individ që kishte shitur kuotat e shoqërisë së tij IM Data shpk, me Nipt L81630006H, shtetasit italian Paolo Palumbo.

Nga të dhënat e QKB-se, identifikohet me konkretisht, Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) L81630006H, Data e Regjistrimit 30/04/2018, Emri i Subjektit IM DATA, Forma ligjore SHPK, Data e themelimit 26/04/2018, Kohëzgjatja Nga: 26/04/2018, Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkiake nr 10, Rruga Islam Alla, Pallati IVEA, Kati 1, Kapitali 100,00, Objekti i aktivitetit Pergatitja dhe mirembajtja e faqeve të internetit, ofrimi domain-esh, shërbimin e eeb hosting, shërbimeve të telekomunikacionit, pergatitja dhe mirembajtja e rrjeteve sociale në internet si dhe marketingu online, mirembajtja dhe riparimi i kompjuterave dhe rrjeteve të komunikimit, etj. Ku aktualisht ky subjekt identifikohet me Administratori/ët Paolo Palumbo dhe Ortakët Paolo Palumbo, mban Statusi: Aktiv.

Ndryshimi i të dhënave të regjistruara në datën 20/07/2018 me Numri i ceshtjes: CN-849736-07-18 Arsytet e hapjes së ceshtjes: Depozitimi i vendimit të asamblese së shoqërisë, date: 04.07.2018, në të cilin është vendosur: Shitja e 100% të kuotave të zotëruara nga ortakut z.Ismail Mici në favor të z. Paolo Palumbo. Depozitimi i kontratës së shitjes së kuotave, date: 04.07.2018.

Si dhe është ndryshuar administratori duke u caktuar aksioneri i vetëm si administrator. Për shtetasin Ismail Mici, rezultuan raportime bankare në vlera të konsiderueshme, të cilat e shfaqin të lidhur përveçse me shoqërinë Im data shpk, dhe me shoqërinë Softlog shpk, ku për veprimet financiare mbizotërojnë përshkrimet "tërheqje cash për shpenzime biznesi".

Shoqëria Softlog shpk, me Nipt L81904031F është themeluar më më 03.07.2018, nga shtetasi

italian Solazzo Salvatore i dtl 01.05.1993. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative nr.5, Rruga Ismail Qemali, Nd.22, H.4, Ap.23, 1019, me Kapitali 100,00, Objekti i aktivitetit Operim ne fushen e menaxhimit. Operim ne fushen e konsulences, Zhvillimin e teknologjive te reja. Prodhime dhe zhvillime te softëereve te ndryshme si dhe marketing online, mirembajtja dhe riparimi i kompjuterave dhe rrjeteve te komunikimit, etj. Shoqeria do te kryeje pa kufizim çdo aktivitet tjeter te lejueshem nga Qegjistracioni ne fuqi edhe pse jo i permendur ne kete akt. Administratori/ët Salvatore Solazzo si dhe aksioner i vetem , ku aktualisht shfaqet me statusi: Aktiv.

Nga historiku i punësimit të shtetasit Ismail Mici, rezulton të ketë punuar pranë:

Brunilda Duka me Nipt L51906004P përgjatë Shtator 2015- Prill 2018. Veprimtaria është e llojit bar- kafe;

Ismail Mici PF me Nipt L71708026F, përgjatë muajve Maj-Tetor 2017;

Im data shpk, me Nipt L81630006H, përgjatë Prill- Qershor 2018;

Mail Center me Nipt L91426017U, përgjatë muajve Shkurt-Qershor 2019.

Veprimtaria Mail Center shpk, me Nipt L91426017U, është themeluar më 25.02.2019, nga shtetasi Ismail Mici i dtl 15.09.1996. Mail Center ka të njëjtën veprimtari sikurse dhe Future Media shpk. Nga verifikimi në C@TS, edhe shoqëria Mail Center nuk rezulton të ketë punonjës të deklaruar.

Organet policore gjithashtu raportojne se nga verifikimi në TIMS: Shtetasi Ismail Mici, rezultoi të kishte lëvizje të përbashkëta me shtetasit Mendim Shpetim Domi dhe Gerald Engjell Lamaj i dtl 03.12.1989.

Nga verifikimet e kryera, edhe shtetasit Mendim Shpetim Domi me ID J31124053M dhe Gerald Engjell Lamaj I91203048R, shihen të lidhur me veprimtari të llojit "Call Center".

Nga verifikimi në burimet e hapura rezulton një shtetas me gjeneralitete Gerald Lamaj dhe me të njëjtën ditëlindje rezulton i përfshirë në trafikim të lëndëve narkotike.

Në konkludim të analizës financiare të rastit rezultojnë indicje dhe anomali të cilat krijojnë dyshime mbi këtë subjekt dhe veprimtarinë e tij si Transferta në mbërritje me anomali dhe terheqjet, të cilat nuk justifikohen në mënyrë të arsyeshme me motivacionin e biznesit; Mungesa e punonjësve të deklaruar, të domosdoshëm për veprimtarisë së llojit Call Center.


Në lidhje me këtë shtetas, janë bërë verifikime të metejshme, në Agjencin Shtetore të Kadastres Tirane ku ka rezultuara se shtetasi Engjell Lamaj ka keto pasuri te paluajtshme:

Zona kadastrale nr 8230 me nr pasurie 6/292+1-6 volum 5 faqe 36 lloji I pasurise apartament me sipërfaqe 74.40 m2 ne bashkepronesi me shtetasen Mimoza Lamaj. Gjithashtu nga informacioni i marre na rezulton se shtetasi Gerald Lamaj dhe Ismail Mici kane ne pronesine e tyre keto automjete:

Mjeti me targa AA 272.

Mjeti me targa AA 960VE.

Sipas informacioneve të marra në rruge operative, për shtetasit Ismail Mici si dhe nga verifikimi i bërë në sistemin TIMS ka rezultuar se ka disa hyrje dhe dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, si dhe lidhjet e dyshimta me shtetasin Gerald Lami, i dyshuar për trafikimin e lëndëve narkotike si dhe shoqërinë e cituara edhe me larte, rezulton se zoterojnë shuma parash, në llogari bankare të çelura në bankat e nivelit të dyte, si dhe kanë kontrata noteriale, shitblerje pasurish te luajtshme dhe paluajtshme kryesisht ne qytetet Tirane. Përfitime dhe të ardhura këto të cilat dyshohen se kanë prejardhje nga aktivitetit kriminal i



shtetasve te lartepemendur.

Sa më sipër, në përfundim të hetimeve prokurori ka arsyetuar se duke pasur parasysh faktet se shtetasi Ismail Mici, ka dyshime se ka perfituar dhe investuar vlera te larta në pasuri të luajtshme dhe te paluajtshme. Megjithse shtetasi i lartepemendur është permendur si firmë e autorizuar ne shoqerin Media Future shpk me nipt L91521009H. Transfertat ne mberritje me anomali dhe terheqiet te cilat nuk justifikohen ne menyre te arsyeshme me motivacionin e biznesit. Informacioneve per hetimet e shtetasit Gerald Lamaj, per trafikimin e lendeve narkotike, si dhe levizja me shtetasin Ismail Mici.

Në konkludim të kësaj analize, lindin dyshime se burimi i fondeve të bllokuara dhe investuara nga shtetasi Ismail Mici, mund te kene prejardhje nga aktiviteti kriminal. Nder veprimet e kryera rezulton se me date 30.01.2020 nga ana e Oficerit te Policise Gjyqesore Qamil Brahja (i cili ka qene fillimisht oficeri i ngarkuar per hetimin e ketij procedimi), i është marre deklarim shtetasit Artan Pajtoni, i cili ka qene me detyre administratori i Qenderes se Biznesit Pajtoni Center. Është pyetur nese ne godinen te cilen ai administron a ka ushtruar aktivitet tregetar shoqeria MEDIA FUTURE me nipt L91521009H me administrator dhe perfaqesues shtetasin italian Rosario Lazzarin me sherbimin Call center. Shtetasi Artan Pajtoni ka deklaruar se nuk kane asnje kontrate dhe asnje dokument midis tyre dhe kjo shoqeri nuk ka qene asnjehere e regjistruar ne kete godine.

Me shkrese 15069/k Prot date 21.08.2020 i eshte kerkuar informacion Zyres Qendrore Interpol Tirana ne lidhje me te gjithë personat qe jane implikuar ne shoqerine Media Future. Nga ana e Zyres Qendrore Interpol Tirana nuk është kthyer akoma pergjigje zyrtare per arsye subjektive dhe objektive, por nga komunikimi i vazhdueshem me kete Drejtori ka rezultuar se në lidhje me subjektin Mendim Domi, nga Interpol Madrid ka ardhur nje informacion se ky subjekt është hetuar ne vitin 2019 si pjese e nje grupi per Mashtrim.

Bazuar në të dhenat e mësipërme është bërë i mundur identifikimin i numrave te telefonit te shtetasve, duke kerkuar venien ne pergjim procedural me afat 15 ditë, si me poshte:

Ismail Mici me nr telefoni 0692524938 dhe 0699461095

Gerald Lamaj me nr telefoni 0698753991

Brunilda Duka me nr telefoni 0696984337

Paolo Palumbo me nr telefoni 0692524938

Salvatore Solozzo me nr telefoni 0698737565

Gjithsesi kjo e dhënë nuk është konsideruar, edhe perfaktin se organet policore kane relatuar se kryesisht keta numra rezultonin te fikur dhe jo aktiv.

Në vijim është kërkuar informacion bankave te nivelit te dyte, per shtetasin Ismail Mici dhe personat e lidhur me te aferm dhe te idetifikuar ne kete material, si dhe personave juridik te relatuar.

Nga korespondencat, duke pasqyruar te dhenat konkrete dhe qe perkojne me periudhat dhe objektin e hetimit, ka rezultuar se shtetasi Mendim Domi identifikohet ne me llogari ne leke me nr. 98189 prane Alpha Banke. Nga ekstrakti verehet se per periudhen 2016-2018 jane kredituar nga ky shtetas 307.318 leke dhe jane terhequr shuma 307.318 leke . Balanca është 0 (zero).

Shtetasi Mendim Domi identifikohet me llogari ne leke me nr. 974209 prane Intesa Sanpaolo Bank. Nga ekstrakti verehet se është hapur ne daten 14.10.2015 dhe jane kredituar nga te trete shume 69.515 leke dhe jane terhequr shuma 69.515 leke . Balanca eshte 0 (zero).

5	10.10.2015	39	It	Francesco Grottaglie	delle	Gerald Lamaj
6	20.11.2015	140	It	Francesco Grottaglie	delle	Gerald Lamaj
7	09.02.2016	73	It	Francesco Grottaglie	delle	Gerald Lamaj
8	25.02.2016	50	It	Francesco Grottaglie	delle	Gerald Lamaj
9	15.03.2016	50	It	Francesco Grottaglie	delle	Gerald Lamaj
10	12.04.2016	275	It	Francesco Grottaglie	delle	Gerald Lamaj
11	14.05.2016	93	It	Francesco Grottaglie	delle	Gerald Lamaj
12	16.05.2016	100	It	Gerald Lamaj		Engjell Lamaj
13	10.10.2016	50	It	Fiqiri Mici		Ismail Mici
14	31.12.2016	91	It	Gerald Lamaj		Hatixhe Byberi
15	20.02.2017	41	BE	Ismail Mici		Alerjo Skeja
16	29.05.2017	590	MD	Mendim Domi		Leonora Grib
17	04.07.2017	41	It	Mendim Domi		Gerald Lamaj
18	05.07.2017	91	It	Mendim Domi		Gerald Lamaj

I është kërkuar informacion subjektivit "Money Gram" për shtetasin Ismail Mici dhe personat e lidhur me të afërm dhe të identifikuar në këtë material, si dhe personave juridik të relatuar. Nga këto korespondenca ka rezultuar :

Në datën 27.12.2018 Ina Lamaj ka marrë shumën 384 euro nga shtetasi Mariglen Kozi, shteti dergues Itali.

Në datën 30.04.2019 Ismail Mici, nga AL, i dërgon në IT shtetasit Fiqiri Mici shumën 200 euro.

Në datën 12.08.2019 Ismail Mici, nga AL, i dërgon në GB shtetasit Davide Ierardi shumën 235 euro.

Në datën 01.10.2019 Ismail Mici, nga AL, i dërgon në GB shtetasit Davide Ierardi shumën 43 euro.

Në datën 16.09.2016 Ismail Mici, në AL, merr nga shtetasi Fiqiri Mici ,IT, shumën 50 euro.

Në datën 12.12.2017 Mendim Domi, nga AL , i dërgon në IL, shtetasit Marko Anticoli shumën 425 euro.

Në datën 26.01.2019 Mendim Domi, nga AL , i dërgon në ES , shtetasit Jusel Mici, shumën 279 euro.

I është kërkuar informacion Qendres Kombëtare të Biznesit për shtetasin Ismail Mici dhe

personat e lidhur me te aferm dhe te identifikuar ne kete material, si dhe personave juridik te relatuar, duke kryezuar informacionin e kerkuar Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane per shtetasin Ismail Mici dhe personat e lidhur me te aferm dhe te identifikuar ne kete material, si dhe personave juridik te relatuar. Nga korespondenca me keto instucione rezulton se subjekti Brunilda Duka me nipt L519060004P ka realizuar fitime rreth 3.000.000 leke nga viti 2015 deri ne vitin 2018, dhe per vitin 2019 nuk ka dorezuar Deklaraten e Tatim Fitimit , nderkohe qe deri ne daten 31.01.2020 rezulton me detyrime te pa shlyera ne shumen 985.189 leke.

Subjekti Mail Center me nipt L91426017U, rezulton pa aktivitet dhe ne listpagesa eshte deklaruar vetem admnsitratori Ismail Mici. Deri ne daten 11.03.2020, rezulton me detyrime ne shumen 5.000 lek , te cilat i perkasin sigurimeve shoqerore.

Subjekti Ismail Mici me nipt L71708026F, ka kaluar me status pasiv ne daten 25.10.2017. Punemarresi Ismail Mici është paguar per periudhen 1705-1710, masatarisht duke u paguar ne shumen 24.000 leke. Rezulton te mos kete dorezuar bilance dhe pasqyra financiare dhe rezulton me detyrime ne shumen 10.000 leke deri ne daten 03.02.2020.

Shtetasja Florine Mici rezulton e punesuar prane subjektit Albel Sa me nipt J61810511V per periudhen 1804-1912 dhe eshte paguar mesatarisht ne shumen 30.000 leke.

Shtetasja Romina Mici rezulton se ka regjistruar Subjektin Romina Demetja me nipt L81322027D, me objekt veprimtarie Sallon Bukurie , dhe identifikohet me detyrime ne kohe reale ne shumen 107.876 leke deri ne date 04.02.2020.

Subjekti Media Future me nipt L91521009H , rezulton pa aktivitet per vitin kalendarik 2019 dhe ne listpagesa eshte deklaruar vetem admnsitratori Rozario Lazarin. Deri ne daten 11.02.2020 , rezulton me detyrime ne shumen 15.000 lek, te cilat i perkasin sigurimeve shoqerore dhe Tvsh.


Shtetasi Engjell Lamaj ka qene i punesuar prane subjektit AMG per periudhen 2012/01 - 2012/08, me page bruto mesatarisht 20.000 leke. Gjithashtu ky shtetas eshte i regjistruar si admnistratori i subjektit ALDE & Co me nipt K02314003C, por rezulton me status pasiv nga data 18.03.2005. Deri ne daten 04.02.2020 ky subjekt rezulton me detyrime ne shumen 1.625.000 leke.

Shtetasja Mimoza Lamaj ka qene e punesuar nga periudha 2011/12 e ne vazhdim prane subjektit Arben Kapollari me Nipt K31614086A me page bruto mesatare 28.000 leke.

Subjekti Gerald Lamaj Pf me nipt L72120009N, Punemarresi Gerald Lamaj eshte paguar per periudhen 1709-1912, masatarisht duke u paguar ne shumen 26.000 leke, megjithese brenda disa periudhave te ketyre listapagesave ato jane me vleren 0(zero). Rezulton te mos kete dorezuar bilance dhe pasqyra financiare sa i perket periudhes 2017 dhe rezulton me detyrime ne shumen 69.030 leke deri ne daten 03.02.2020.

Subjekti Soft Log shpk me nipt L81904031F, nuk ka deklaruar te punesuar dhe pasqyra fnciare ne historik, as per admnistratorin, dhe gjithashtu referuar detyrimeve ne kohe reale deri ne daten 31.03.2020 rezulton me detyrime ne kohe reale ne Shumen 203.776 leke. Ky subjekt ka kaluar me status pasiv ne daten 26.07.2019.

Sa i perket subjektit Im Data shpk me nipt L81630006H, ka deklaruar listpagesa vetem per shtetasin Ismail Mici per 1804-1806 ne Shumen 70.000 leke dhe me lispagesa te deklaruar. Ky subjekt nuk ka deklaruar bilance dhe pasqyra financiare per vitet 2018 dhe 2019, dhe figuron me detyrime ne shumen 448.855 leke deri ne date 03.02.2020. Admnistratori deri ne ne periudhen 20.07.2018 ka qene shtetasi Ismail Mici dhe me pas i ka kaluar shtetasit Italian Paolo Palumbo.



Subjekti Digitally Italia shpk me nipt L91625015F është krijuar ne daten 25.04.2019 me admnistratore shtetasin Italian Paolo Palumbo, figuron me status aktiv dhe nuk ka dorezuar balance. Rezulton me detyrime te papaguara ne shumen 5.000 leke deri ne deten 03.02.2020.

Së fundmi rezulton te jete hapur subjekti Super Foods me nipt M01310010L ku nga te dhenat e Qkb-se rezulton me 40% Gerald Lamaj, 40% Mendim Domi dhe 20% Jusel Mici. Rezulton pa detyrime deri ne daten 03.02.2020.

Nga korespondenca me DRT Tirane, është identifikuar edhe subjekti Profiter Shpk me nipt L71306013V. Ky subjekt me admnistratore shtetasin Giuseppe Romeo rezulton me detyrime ne kohe reale ne shumen 10.047.242 leke deri ne daten 13.02.2020. Ne listpagesat e ketij subjekti identifikohet shtetasi Mendim Domi duke u paguar ne shumen 22.000 leke. Ky Subjekt per periudhen janar 2018 ka realizuar shitje ndaj subjekti Investment 4 Futures LTD, i regjistruar ne Shen Vincenti dhe Grenadinet, ne Shumen 18.440.940 leke.

Shtetasi Mendim Domi, figuron si punemarres prane subjektit Mendim Domi Pf me nipt L62412001J per periudhen 2016/12-2017/11 si dhe per periudhen 2019/05-e ne vazhdim. Shtetasi Mendim Domi rezulton te jete admnistratore i subjektit Vibemedia shpk me nipt L81523027O, i cili ka kaluar me status pasiv me daten 26.09.2019. Detyrimet ne kohe reale per kete subjekt jane ne shumen 282.399 leke deri ne daten 04.02.2020.

I është kërkuar informacion DPSHTRR-se per shtetasin Ismail Mici dhe personat e lidhur me te aferm dhe te idetifikuar ne kete material, si dhe personave juridik te relatuar. Nga korespondencat ka rezultuar se Gerald Engjell Lamaj ka te regjistruar automjetin me targa AA272XN, ku nga analizimi i praktikës rezulton te jete nje automjet tip VolkSëagen Pasat i viti 2006 , ky mjet rezulton te jete blere ne prillin e vitit 2019 , dhe është pershtatur prane subjektit Shpresa AI, per kategorine Invalid. Nga te dhenat rezulton te jete blere ne gjermani ne shumen 2300 euro. Ina Engjell Lamaj ka te regjistruar automjetin me targe AA531UG

Ismail Hysni Mici ka te regjistruar automjetin me targe AA960UE, ku nga analizimi i praktikës rezulton te jete nje automjet tip Fiat Bravo, ky mjet rezulton te jete blere ne tetorin e vitit 2018. Nga te dhenat rezulton te jete blere prane Subjektit Mix Auto Shpk ne Shumen 367.000 leke.

Mendim Shpetim Domi ka te regjistruar automjetin me targe AA270XN. Shtetasit e tjere si dhe personat juridik te permendur ne shkrese nuk posedojne automjete.

I është kërkuar informacion Ministrise se Financave, Drejtorise se Drejtimit te Prones Publike per shtetasin Ismail Mici dhe personat e lidhur me te aferm dhe te idetifikuar ne kete material, si dhe personave juridik te relatuar. Nga korespondenca me nr 1783/1 date 10.02.2020 nuk ka rezultuar te dhena pozitive ne ngarkim te individeve apo personave juridik. I është kërkuar Informacion Drejtorise se Pergjitheshme te Aluiznit per shtetasin Ismail Mici dhe personat e lidhur me te aferm dhe te idetifikuar ne kete material, si dhe personave juridik te relatuar. Nga korespondencat ka rezultuar se me vetedeklarimin nr 642 date 20.11.2006 shtetasi Hysni Mici, qe nga te dhenat e certifikatave familjare rezulton te kete aplikuar per legalizim, prane Drejtorise Vendore Kamez-Vore, per nje banese 1 kateshe me siperfaqe ndertimi 85 m2, e ndodhur ne Gjokaj, Vore.

I është kërkuar informacion Agjensise Shtetore te Kadastres per shtetasin Ismail Mici dhe personat e lidhur me te aferm dhe te idetifikuar ne kete material, si dhe personave juridik te relatuar. Ne këtë korespondence identifikohet Pasuria nr. 2/194+1-1 ne Zk nr 8230, me siperfaqe 62 m2, ne emer te Enkeleide, Serkida dhe Mendim Domi, regjistruar ne daten 20.07.2013, perfituar me Deshmin e Trashegimise nr 3262/1027/08. Pasuria nr. 1-6 ne zk nr 8230 , me siperfaqe 74 m2 , ne emer te Engjell dhe Mimoza Lamaj, regjistruar ne daten 21.07.2013, nepermjet kontrates se dhurimit nr 164 rep dhe nr 56 kol date 02.02.1999.

I është kërkuar informacion Drejtorise se Pergjitheshme te Burgjeve, Zyra e Gjendjes Gjyqesore, e cila ne shkresen e saj me nr 737/1 date 26.08.2020 se shtetasit objekt verikimi nuk kanë shenime ne sistem.

I është kërkuar informacion zyres se Interpolit, ku DPP nepermjet kesaj zyre ka infromuar ne daten 29.10.2020, se vetem per subjektin Mendim Domi, nga Interpol Madrid ka ardhur nje informacion se ky subjekt eshte hetuar ne vitin 2019 si pjese e nje grupi per Mashtrim.

Pasqyrimi ne menyre te permbledhur i te dhenave ne kete material, duke veçuar te dhenat konkrete dhe dukshem krijojme bindjen se kemi te bejme me veprimtari kriminale.

Subjekti Soft Log Shpk identifikohet me llogarin nr. 914287, ne monedhen euro prane bankes Intesa Sanpaolo Bank, llogari e cila eshte hapur ne daten 20.07.2018 dhe deri ne daten 20.12.2018, ne kete jane kryer kreditime nga te trete ne shumen 866.539 euro dhe debitime vetem nga shtetasi Ismail Mici ne shumen 866.539 euro, me pas balanca ka kaluar zero.

Referuar te dhenave te Qkb-se rezulton se ky subjekt eshte themeluar ne daten 03.07.2018 dhe regjistruar ne daten 04.07.2018, nga shtetasi Salvatore Solazzo i cili e ka pasur dhe ne administrim. Ky shtetas Italian, identifikuar bazuar ne aktetet publike te QKB-se, identifikohet ne sistemin Tims, si shtetasi Salvatore Solazzo i datelindjes 01.05.1993 me nr dokumenti AY4352882. Ky shtetas rezulton te kete hyre vetem njehere ne RSh ne daten 03.07.2018, me linjen Alitalia Rome dhe rezulton te kete dale ne daten 06.07.2018, po me te njejten linje fluturimi.

Subjekti Media Future Shpk identifikohet me llogarin nr 240218, ne monedhen euro prane bankes Intesa Sanpaolo Bank, llogari e cila eshte hapur ne daten 08.04.2019 dhe deri ne daten 23.01.2020, ne kete jane kryer kreditime nga te trete ne shumen 709.249 euro dhe debitime vetem nga shtetasi Ismail Mici ne shumen 694.763 euro, me pas balanca ka ngrire ne shumen e cila eshte gjendje edhe sot ne shumen 14.485 euro.

Referuar te dhenave te Qkb-se rezulton se ky subjekt eshte themeluar ne daten 18.03.2019 dhe regjistruar ne daten 21.03.2019, nga shtetasi Rosario Lazzarin i cili e ka pasur dhe ne administrim. Ky shtetas Italian, identifikuar bazuar ne aktetet publike te QKB-se, identifikohet ne sistemin Tims, si shtetasi Rosario Lazzarin i datelindjes 27.10.1978 me nr dokumenti AT4610426. Ky shtetas rezulton te kete hyre vetem njehere ne RSh ne daten 18.03.2019, me linjen Blue Panorama-Bologna dhe rezulton te kete dale ne daten 21.03.2019, po me te njejten linje fluturimi.

Ismail Mici identifikohet te kete kryer terheqjet nga llogari e subjektit Im Data, llogari e cila eshte hapur ne daten 16.05.2018, me nr 03204, prane bankes BKT. Ne kete llogari deri ne daten 29.06.2018, është kredituar ne shumen 66.620 euro dhe total kjo shume është terhequr nga shtetasi Ismail Mici. Referuar te dhenave te Qkb-se rezulton se ky subjekt është themeluar në datën 26.04.2018 dhe regjistruar ne daten 30.04.2018, nga shtetasi Ismail Mici. Në datën 04.07.2018, shtetasi Ismail Mici, ka transferuara kuotat tek shtetasi Italian Paolo Palumbo, ky i fundit perveçse pasqyrohet si aksioner i vetem tashme, rezulton edhe të jetë bërë admnistratori i subjektit. Ky shtetas Italian, identifikuar bazuar ne aktetet publike te QKB-se, identifikohet ne sistemin Tims, si shtetasi Paolo Palumbo i datelindjes 13.07.1998 me nr dokumenti AY4352912. Ky shtetas rezulton te kete hyre 3(tre) njehere ne RSh, pasqyruar sipas tabelës se meposhteme:

Hyrje	Dalje	Dite Qendrimi	Pika Kufitare perdorur	e
30.07.2019	31.07.2019	1 dite	Rinas	

23.04.2019	26.04.2019	3 dite	Rinas
03.07.2018	06.07.2018	3 dite	Rinas

Vlen te theksohet se shtetasi Salvatore Solazzo te kete udhetuar me te njejten linje dhe date me shtetasin italian Paolo Palumbo, konkretisht ne daten 03.07.2018 duke u kthyer serisht bashke ne shtetin Italine ne daten 06.07.2018.

Referuar te dhenave policore dhe duke vecuar subjektet te pasqyruara si figura kryesore, nuk ka rezultuar qe shtetasit Mendim Domi dhe Gerald Lamaj, te kene pasur marredhenie ekonomike me shtetasit Italian objekt hetimit. Nga analizimi i llogarive bankare identifikohet vetem shtetasi Ismail Mici, si person i autorizuar per kryerjen e veprimeve bankare per llogari te tre subjekteve , te cilat jane kredituar ne vlere te konsiderueshme.

Organi procedues ka bere te mundur pyetje e shtetasit Ismail Mici, i cili ka shpjeguar si me poshte:

Pyetje: Cfare veprimtarie ka pasur subjekti Im Data , regjistruar nga ana juaj ne daten 30.04.2018?

Pergjigje: Ky subjekt, ne dijenin time ka qene me funksion call center. Dua te shpjegoj se une kete aktivitate e hapa, me kerkese dhe porosi te shtetasit Italian Paolo Palumbo, pasi, pas disa kohesh, une kuotat e shoqerise do ti transferoje tek ky shtetas, pra kam vepruar ne mirbesim dhe per llogari te ketij shtetasi, defakto duke mos qene perfitues, vecse duke pritur sipas premtimeve , shperblim nga ky shtetas.

Pyetje: Cafre pune kryenit ju per kete subjekt , me konkretisht kush kane qene veprimet e tua?

Pergjigje: Une , kontaktohesha nga ky shtetas, nepermjet tefonit ose verbalisht dhe merrja udhezime kryesisht, per tu paraqitur ne banke, me qellim terheqien e shumave qe levroheshin ne llogarine e subjektit nga aktiviteti i saj.

Pyetje: Rezulton se ne daten 04.07.2018 , keni transferuara kuotat tek shtetasi Italian Paolo Palumbo, ky i fundit pervecse pasqyrohet si aksioner i vetem tashme, rezulton edhe te jete bere administrator i subjektit. Gjithashtu nga te dhenat e disponueshme rezulton se ju keni terhequr shumen prej 66.620 euro nga llogaria e subjektit Im Data prane bankes Bkt ne llogarine nr 03204. Pas terheqieve cfare veprimi kryenit konkretisht?

Pergjigje: Sic theksova me lart , duke qene se defakto kjo shoqeri i perkiste shtetasit Paolo Palumbo, une keto shuma jam kam dorezuar keti shtetasi ne gjendje Kesh.

Pyetje: Kush ishte perfitimi juaj nga kjo shume?

Pergjigje: Sic theksova me larte , ky person me kishte permtuar se do te perfitoja te ardhura te ligjeshme sapo kompania te dilte me fitim. Ne rastin konkret une nuk kam perfituar asnje te ardhur.

Pyetje: Si jeni njohur me shtetasin Paolo Palumbo?

Pergjigje: Une kete shtetas e kam njohur ne rrethana rastesore, pasi frekuentonte lokaline ku une punoja si menaxher, konkretisht Haris Bar. Ne krijuam miqesi dhe une krijoja respekt dhe besim per kete shtetas.

Pyetje: A njehesh me shtetasin Salvatore Solazzo?

Pergjigje: Po une me kete shtetas njihem.

Pyetje: Ne cfare kushtesh je njohur me kete shtetas?

Pergjigje: Dua te shpjegoj se me kete shtetash jam njohur nga shtetasi Paolo Palumbo.

Pyetje: Cafre mardhenie kishte shtetasi Salvatore Solazzo me shtetasin Paolo Palumbo ne dijenin tuaj?

Pergjigje: Ne dijenin time kishin mardheni bizensi pasi flisnin per kontrata sherbimesh te ndryshme qe ofronin nepermjet internetit.

Pyetje: A keni kryer ju ndonjehere veprime bankare per llogari te shtetasit Salvatore Solazzo?

Pergjigje: Me sa mbaj mend un kam kryer vperime ne banke per kete shtetas dhe subjektin e tij te cilin nuk i kujtoj emrin per momentin.

Pyetje: Ne cilen banke i keni kryer veprimet per llogari te Salvatore Solazzos dhe subjektit te tij?

Pergjigje: Me sa mbaj mend kam kryer veprime prane bankes Intesa Sanpaolo, prane deges te rruga e kavajes.

Pyetje: Nga te dhenat rezulton se ju keni terhequr shumen prej 866.539 euro , nga llogaria e subjektit Soft log , me administrator shtetasin Salvatore Solazzo. Cili ka qene perfitimi juaj nga kjo shume?

Pergjigje: Une nuk kam perfituar asnje ardhur nga kjo shume pasi , pasi cdo terheqie un ja dorzoja Salvatore nepermjet nje personi italian me emrin Andrea. Kete shtetas ma kishte prezatuar Salvatore.

Pyetje: A njeheni me shtetasin Rosario Lazzarin?

Pergjigje: Po njihem me kete shtetas , serisht njihem nepermjet Paolos dhe Salvatore.

Pyetje: A keni kryer veprime bankare per shtetasin Rosario?

Pergjigje: Po kam kryer, ne te njetat kushte si per shtetasin Paolo dhe Salvatore.

Pyetje: Nga te dhenat rezulton se ju keni terhequr shumen prej 694.763 euro , nga llogaria e subjektit Media Future nene administrimin e shtetasit Rosario Lazzarin ? Cili ka qene perfitimi juaj?

Pergjigje: Une nuk kam perfituar asnje te ardhur nga kjo shume. Cdo terheqie, sipas porosise une ja dorzoja shtetasit italian me emrin Andrea.

Pyetje: Kur eshte hera e fundit qe je takuar me shtetasit e sipercituar?

Pergjigje: Dua te shpjegoj sa un jam ndjer i mashtruar nga keta shtetas, pasi ne nje moment keta shtetas fiken telefonat dhe shkeputen cdo kontakt me mua. Gjate gjithë kohes, keta shtetas me prezantonin sikur do bashkoheshin dhe do hapnin nje kompani me te medha dhe une do kisha nje pozicion pune me te ardhura shume te mira.


Pyetje: A jeni ne dijeni ju se keta shtetas , nuk kan dorezuar bilanca prane tatimeve dhe se nuk kan paguar ansje detyrim ndaj shtetit per kreditimet te cilat jane debitur nga ana juaj per nje perudhe shume te shkurter?

Pergjigje: Nuk kam dijeni, pasi une isha i autorizuar vetem per terheqien e kreditimeve te ketyre shoqerive. Ne dijeni time cdo veprim tjeter administrativ e kryenin vete.

Pyetje: A njihesh me shtetasin Mendim Domi?

Pergjigje: Po njihem dhe kemi mardhenie shoqerore.

Pyetje: A njihesh me shtetasin Gerald Lamaj?



Pergjigje: Po njihem dhe kemi marrdhenie shoqerore.

Pyetje: A njehet Mendimi dhe Geraldini me shtetasit Italian te cituar me siper?

Pergjigje: Ne dijenin time nuk njihen.

Pyetje: A mund te na vini ne dispozicion numra kontakti te shtetesave italian ; konkretisht Paolo, Salvatore, Rosario dhe Andre, numra me te cilet ke folur ne historik?

Pergjigje: Une i kam pasur te gjitha kontaktet e tyre, por kur nderrova telefonin , pasi i vjetri mu prish , mua me humben te gjitha kontaktet. Keta shtetas u zhduken nga jeta ime ne menyre te papritur.

Pyetje: Nese ju do ti shihnit keta shtetas a mund ti identifikoni?

Pergjigje: Po , mendoj se jam ne gjendje ti identifikoj.

Pyetje: A mund te na beni nje pershkrim te shtetasit Andrea?

Pergjigje: Ka qene rreth moshes 30 vjec, rreth 1.75 i gjate, me pak mjeker , me syze optike, floke te qethura shkurt . mbaj mend qe kete shtetas e therrisnin ekonomisti dhe mbante gjithmone nje cante laptopi me vete.

Mbi bazen e te dhenave te administruara organi procedues ka fluar ne cilesine e ekspertes Znj.Adriana Kalaja, me qellim kryerjen e ekspertimit kontabel, ne funksion te pyetjeve te organit procedues, si me poshte:

DETYRA E PARË: - Cila është shmangia e detyrimeve tatimore e realizuar nga subjekti “Soft Log” sh.p.k?

Përgjigje: Bazuar në dokumentacionin e ndodhur në dosjen hetimore, rezulton se shoqëria “Soft Log” sh.p.k, është një shoqëri e së drejtës shqiptare në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe që e ushtron aktivitetin e saj bazuar në legjislacionin shqiptar. Sipas ekstraktit historik nxjerrë nga QKB Tiranë, shoqëria është rregjistruar më datë 04.07.2018, kapitali i kësaj shoqërie është 100,000 lekë e ndarë në 1,000 kuota me 1,000 kuota, me objekt të aktivitetit: “Operim në fushën e menaxhimit. Operim në fushën e konsulencës etj.” me administratorë Salvatore Solazzo dhe ortakë Salvatore Solazzo me 100% pjesmarrje në kapital. Statusi i shoqërisë deri në momentin e përpilimit të aktit të ekspertimit është “aktiv”. Kontrolli i dokumentacionit të ndodhur në dosjen hetimore siguroi se ky subjekt është rregjistruar pranë sistemit tatimor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me NUIS L81904031F.

Sipas të dhënave të sistemit tatimor për këtë subjekt të administruar në dosjen hetimore rezulton se:

Subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga paga me listëpagesa respektive përgjithë periudhën për administratorin Salvatore Solazzo;

Deklarimet e subjektit në lidhje me TVSH-në për gjithë periudhën janë zero;

E njëjta situatë është edhe për Tatim Fitimin e Thjeshtuar ku deklarimet për gjithë periudhën janë zero.

Në lidhje me këto deklarime me zero dhe me deklarime në vonesë, nga sistemi tatimor për këtë subjekt janë gjeneruar detyrime të cilat paraqiten:

Lloji i tatimit mbi te cilin dalin detyrimet	Detyrimi kryesor	Gjobë e rregjistruar	Gjobë e paregjistruar	Interes i parregjistruar	Totali i detyrimit
--	------------------	----------------------	-----------------------	--------------------------	--------------------

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	75,000	60,000	16,425	5,510	156,935
Tatim i Thjeshtuar Fitimi	25,000	5,000	5,370	1,471	36,841
Kontributet për sigurimet	0	10,000	0	0	0
Totali	100,000	75,000	21,795	6,981	203,776

Si shikohet sa më sipër, në total detyrimet e kësaj shoqërie në lidhje me mosdeklarimet janë në shumën: 203,776 lekë.

Kontrolli i dokumentacionit të ndodhur në dosjen hetimore siguroi se nga ana e subjektit, nuk janë deklaruar fatura tatimore si në blënjë ashtu dhe në shitje.

Po kështu, në lidhje me këtë pyetje sqaroj Organin e Akuzës se shmangia nga detyrimet ka ardhur si pasojë e mosdeklarimit të të ardhurave (shitjet apo shërbimet).

DETYRA E DYTE: - *Cila është shmangia e detyrimeve tatimore e realizuar nga subjekti "Media Futurë" sh.p.k?*

Pergjigje: Referuar dokumentacionit të ndodhur në dosjen hetimore, rezulton se shoqëria "Media Futurë" sh.p.k, është një shoqëri e së drejtës shqiptare në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe që e ushtron aktivitetin e saj bazuar në legjislacionin shqiptar.

Sipas ekstraktit historik nxjerrë nga QKB Tiranë, kjo shoqëri është regjistruar më datë 21.03.2019, kapitali i kësaj shoqërie është 10,000 lekë e ndarë në 1,000 kuota me objekt të aktivitetit: "Ofrimi i shërbimeve call center dhe të kontaktit telefonik në përgjithësi edhe nëpërmjet marrjes dhe kalimit të telefonatave, e gjitha si për llogari të sasj edhe për llogari të të tretëveçj.", me administratorë Rosario Lazzarin dhe ortakë Rosario Lazzarin me 100% pjesëmarrje në kapital. Statusi i shoqërisë deri në momentin e përpilimit të aktit të ekspertimit është "aktiv".

Referuar të dhënave të sistemit tatimor për këtë subjekt, që i korespondon NIPT-it 191521009H të administruar në dosjen hetimore situta financiare rezulton të jetë:

Subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga paga me listëpagesa respektive përgjithë periudhën për administratorin Salvatore Solazzo;

Deklarimet e subjektit në lidhje me TVSH-në për gjithë periudhën janë zero;


E njëjta situatë është edhe për Tatim Fitimin e Thjeshtuar ku deklarimet për gjithë periudhën janë zero.

Edhe në lidhje me këtë subjekt, sqaroj se shmangia nga detyrimet ka ardhur si pasojë e mosdeklarimit të të ardhurave (shitjet apo shërbimet).

DETYRA E TRETE: *Cila është shmangia e detyrimeve tatimore e realizuar nga subjekti "Im Data" sh.p.k?*

Pergjigje: Kontrolli i dokumentacionit të ndodhur në dosjen gjyqore siguroi se shoqëria "Im Data" sh.p.k, është një shoqëri e së drejtës shqiptare në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe që e ushtron aktivitetin e saj bazuar në legjislacionin shqiptar.

Sipas ekstraktit historik nxjerrë nga QKB Tiranë, kjo shoqëri është regjistruar më datë 30.04.2018, kapitali i kësaj shoqërie është 100,000 lekë e ndarë në 1,000 kuota me 1,000



kuota, me objekt të aktivitetit: "Përgatitja dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit, ofrim domain-esh, shërbime e ëeb hosting, shërbime telekomunikacioi etj.", me administratorë Paolo Palumbo dhe ortakë Paolo Palumbo me 100% pjesëmarrje në kapital. Sipas të dhënave të ekstraktit historik të kësaj shoqërie, më datë 04.07.2018 është vendosur shitja e kuotave nga ortaku Ismail Mici te z. Paulo Palumbo, i cili bëhet ortak i vetëm i kësaj shoqërie dhe administrator i saj që nga data 04.07.2018. Po kështu, sipas të dhënave të këtij ekstrakti, statusi i shoqërisë deri në momentin e përpilimit të aktit të ekspertimit është "aktiv". Kontrolli i dokumentacionit të ndodhur në dosjen hetimore siguroi se ky subjekt është regjistruar pranë sistemit tatimor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me NUIS L8163006II.

Sipas të dhënave të sistemit tatimor për këtë subjekt të administruar në dosjen hetimore rezulton se:

Subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga me listëpagesa respektive për periudhën 30.04.2018 - 20.07.2018 për administratorin Ismail Mici;

Deklarimet e subjektit në lidhje me TVSH-në për gjithë periudhën janë zero;

Deklarimet në lidhje me shitjet pa TVSH janë në shumën 44,247,312 lekë;

Për periudhën 2018-2020, detyrimet e subjektit ndaj organeve tatimore janë 448,855 lekë;

Nuk ka deklarime në lidhje me Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin për gjithë periudhën dhe për këtë arsye është gjobitur me 25,000 lekë për çdo vit.

DETYRA E KATËRT: Cilat janë të ardhurat dhe burimet e krijimit për shetasin Ismail Mici dhe personave të lidhur me të?

Përgjigje: Bazuar në dokumentacionin e ndodhur në dosjen hetimore rezulton se shtetsi Ismail Mici figuron:

Ortak me 100% të aksioneve në shoqërinë "Mail Centër" sh.p.k me NIPT L91426017U;

Ortak me 100% të aksioneve në shoqërinë "Im Data" sh.p.k me NIPT L81630006H për periudhën 30.04.2018-20.07.2018;

Person Fizik "Ismail Mici" me NIPT L71708026F;

Referuar ekstrakteve historike të administruara në dosjen hetimore rezulton se:

Sipas ekstraktit historik nxjerrë nga QKB Tiranë, shoqëria "Mail Centër" sh.p.k, është regjistruar më datë 26.02.2019, me NIPT L91426017U, me kapital 10,000 lekë, me objekt të aktivitetit: "Ofrimin e shërbimeve call center dhe të kontaktit telefonik në përgjithësi, edhe nëpërmjet marrjes dhe kaslimit të telefonatave, e gjitha për llogari të saj për llogari të të tretëve etj.", me administratorë dhe ortakë të vetëm Ismail Mici;

Sipas ekstraktit historik nxjerrë nga QKB Tiranë, shoqëria "Im Data" sh.p.k, është regjistruar më datë 30.04.2018, me NIPT L8163006H, me kapital 100,000 lekë e ndarë në 1,000 kuota me 1,000 kuota, me objekt të aktivitetit: "Përgatitja dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit, ofrim domain-esh, shërbime e ëeb hosting, shërbime telekomunikacioi etj.", me administratorë dhe ortakë të vetëm Ismail Mici nga data 30.04.2018 deri 04.07.2018;

Referuar ekstraktit historik nxjerrë nga QKB Tiranë, Ismail Mici figuron i regjistruar si "Person Fizik" sh.p.k, më datë 08.05.2017, me NIPT L71708026F, me status "pezulluar" nga data 25.10.2017.

Kontrolli i dokumentacionit të ndodhur në dosjen hetimore siguroi se nga subjektet e mësipërme, pranë sistemit tatimor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, kemi këto

deklarime:

Shoqëria "Mail Centër" sh.p.k:

Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen hetimore, subjekti ka detyrime në shumën 5,000 lekë për deklarim me vonesë të listëpagesave;

Dokumentacioni i audhur nga orgaet tatimore sqarjné se për vitin 2019 subjekti nuk ka zhvilluar aktivitetet;

Po kështu, sipas këtij dokumentacioni rezulton se kjo shoqëri ka deklaruar paga vetëm për administratorin për vitin 2019:

Periudha	Paga baze	Kontribute gjithsej	Tatimi	Paga neto
Shkurt 2019	26,000	7,254	0	18,746
Mars 2019	26,000	7,254	0	18,746
Prill 2019	26,000	7,254	0	18,746
Maj 2019	26,000	7,254	0	18,746
Qershor 2019	26,000	7,254	0	18,746
Korrik 2019	26,000	7,254	0	18,746
Gusht 2019	26,000	7,254	0	18,746
Shtator 2019	26,000	7,254	0	18,746
Tetor 2019	26,000	7,254	0	18,746
Nëntor 2019	26,000	7,254	0	18,746
Dhjetor 2019	26,000	7,254	0	18,746
Total				206,206

Shoqëria "Im Data" sh.p.k:

Në lidhje me këtë shoqëri, detajet në lidhje me deklaratimet apo detyrimet ndaj organeve tatimore i kam dhënë në detyrën e tretë.

Paga e përfituar nga shtetasi Ismail Mici për tre muaj paraqitet si më poshtë:

Periudha	Paga baze	Kontribute gjithsej	Tatimi	Paga neto
Prill 2018	1,923	353	0	1,570
Maj 2018	70,000	7,840	5,200	56,960
Qershor 2018	70,000	7,840	5,200	56,960
Total				115,490

“Person Fizik” Ismail Mici:

Paga e përfituar nga shtetasi Ismail Mici për pesë muaj që ky aktivitet ka qënë aktiv paraqitet

Periudha	Paga baze	Kontribute gjithsej	Tatimi	Paga neto
Maj 2017	24,000	7,152	0	16,848
Qershor 2017	24,000	7,152	0	16,848
Korrik 2017	24,000	7,152	0	16,848
Gusht 2017	24,000	7,152	0	16,848
Shtator 2017	24,000	7,152	0	16,848
Total				84,240

Kontrolli i dokumentacionit të ndodhur në dosjen hetimore siguroi se shtetësja Florine Mici figuron e punësuar pranë shoqërisë “Albel” SA me NIPT J61810511V dhe ka përfituar pagë për periudhën prill 2018 - dhjetor 2019:

Periudha	Paga baze	Kontribute gjithsej	Tatimi	Paga neto
Prill 2018	7,360	2,053	0	7,360
Maj 2018	24,000	6,696	0	24,000
Qershor 2018	24,000	6,696	0	24,000
Korrik 2018	24,000	6,696	0	24,000
Gusht 2018	25,554	7,130	0	25,554
Shtator 2018	24,000	6,696	0	24,000
Tetor 2018	28,846	8,048	0	28,846
Nëntor 2018	26,272	7,413	0	26,272
Dhjetor 2018	24,000	6,696	0	24,000
Janar 2019	26,000	7,254	0	26,000
Shkurt 2019	26,000	7,254	0	26,000
Mars 2019	29,751	8,301	0	29,751
Prill 2019	31,256	8,557	163	22,536
Maj 2019	26,000	7,254	0	26,000
Qershor 2019	27,275	7,609	0	27,275
Korrik 2019	38,876	9,692	1,154	28,030

Gusht 2019	35,540	9,195	720	25,625
Shtator 2019	35,656	9,212	735	25,709
Tetor 2019	35,366	9,169	698	25,499
Nëntor 2019	30,008	8,371	1	21,636
Dhjetor 2019	28,797	8,035	0	28,797
Total				520,890

DETYRA E PESTË: - A ka gjeneruar të ardhura shtetasi Ismail Mici nga marrëdhënia ekonomike e subjektit "Im Data" sh.p.k, në kuptim të Ligjit për shoqëritë tregtare dhe Ligjit për procedurat tatimore?

Përgjigje: Bazuar në dokumentacionin e ndodhur në dosjen hetimore, rezulton se kjo shoqëri është regjistruar më datë 30.04.2018, me kapital 100,000 lekë, kapital i cili më datë 04.07.2018, sipas kontratës së shitjes, ka kaluar nga shtetasi Ismail Mici te z. Paulo Palumbo i cili bëhet ortak i vetëm i kësaj shoqërie dhe administrator i saj që nga data 04.07.2018.

Sipas Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2018 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të gjithë marrëdhëniet me organet shtetërore, bankat apo edhe të tretë të përfshirë te këto grupe i mban administratori.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve të këtij ligji, administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në

mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administrator kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave

të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar të dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

Bazuar në dokumentacionin ndodhur në dosjen hetimore rezulton se shtetasi Ismail Mici duke patur të drejtën për tërheqje dhe derdhje në llogaritë bankare të shoqërisë “Im Data” sh.p.k ku ka qënë administrator, ka kryer këto veprime pranë BKT-së:

Përshkrimi i veprimit	Datë	Debi	Kredi	Gjendja
Transfertë Provider Uk Limited	24.05.2018		5,520.97	5,520.97
Tërheqje Ismail Mici	25.05.2018	4,000.00		1,570.97
Tërheqje Ismail Mici	29.05.2018	1,515.00		70.97
Komisione	29.05.2018	2.50		53.47
Transfertë Raphe Consulting	29.05.2018		34,829.37	34,882.84
Tërheqje Ismail Mici	13.06.2018	34,600.00		282.84
Tërheqje Ismail Mici	25.06.2018	200.00		82.84
Komisione	29.06.2018	2.50		80.34
Transfertë Patella Management	29.06.2018		26,220.39	26,300.73
Tërheqje Ismail Mici	02.07.2018	20,000.00		6,300.73
Tërheqje Ismail Mici	18.07.2018	6,300.00		0.73
Tërheqje Ismail Mici	18.07.2018	0.73		0.00
Total		66,620.73	66,620.73	0.00

Siç shikohet, për gjithë periudhën nga shtetasi Ismail Mici janë tërhequr në total 66,620.73 Euro, në një kohë që nuk ka asnjë faturë të deklaruar si në Organet Tatimore si në bankë për shitje shërbimi nga ana e shoqërisë “Im Data” sh.p.k.

DETYRA E GJASHTË: - Cilat janë shkeljet administrative të realizuara nga subjektet “Soft Log” sh.p.k, “Media Futurë” sh.p.k dhe “Im Data” sh.p.k?

Përgjigje: Kontrolli i dokumentacionit të ndodhur në dosjen hetimore siguroi se shkeljet administrative nga ana e subjekteve “Soft Log” sh.p.k, “Media Futurë” sh.p.k dhe “Im Data”

sh.p.k, konsistojnë në arkëtimin e shumave të ndryshme në llogaritë bankare të këtyre subjekteve në një kohë që nuk ka të deklaruar fatura tatimore shitje për shërbimet e ofrurara.

Situatën e transfertave bankare dhe tërheqjeve në llogarinë e shoqërisë "Im Data" sh.p.k janë dhënë në detyrën e pestë.

Në këto kushte paraqes lëvizjet në llogarinë bankare të dy subjekteve objekt i hetimit penal pranë Intesa Sanpaolo Bank:

"Media Futurë" sh.p.k me Nr.240218 Llogarie:

Debi: 694,763.65 Euro;

Kredi: 709,249.15 Euro;

Mbetja: 14,485.50 Euro.

Në lidhje me këtë llogari sqaroj se tërheqjet janë bërë të gjitha nga shtetasi Ismail Mici me pershkrimi "shpenzime biznesi" ndërsa transfertat nga kompanitë:

Moormand LTD;

Vogue Eeb Solution;

Flutterëave Technology;

Luxor SRL.

"Soft Log" sh.p.k me Nr.914287 Llogarie:

Debi: 866,539.69 Euro;

Kredi: 866,539.69 Euro;

Mbetja: 0.00 Euro.

Në lidhje me këtë llogari sqaroj se tërheqjet janë bërë të gjitha nga shtetasi Ismail Mici me pershkrimi "shpenzime biznesi" ndërsa transfertat nga kompanitë:

Moormand LTD;

Vast Impex SRL;

Card service provider;

Ëidestep GMBH;


Lead secure LTD.

DETYRA E SHTATË: - A mund të identifikohet shtetasi Mendim Domi si përfitues apo palë në marrëdhënie ekonomike me subjektet "Soft Log" sh.p.k, "Media Futurë" sh.p.k dhe "Im Data" sh.p.k bazuar në ekstraktet bankare dhe financiare të administruara në fashikullin hetimor?

Përgjigje: Referuar dokumentacionit të ndodhur në dosjen hetimore, dhe konkretisht ekstraktet e të gjithë bankave të administruara nga Organi i Akuzës, nuk rezulton që shtetasi Mendim Domi të ketë përfiturar të ardhura nga subjektet "Soft Log" sh.p.k, "Media Futurë" sh.p.k dhe "Im Data" sh.p.k.

Po kështu, nuk rezulton që shtetasi Mendim Domi të ketë marrëdhënie ekonomike me subjektet "Soft Log" sh.p.k, "Media Futurë" sh.p.k dhe "Im Data" sh.p.k.

DETYRA E TETË: - A mund të identifikohet shtetasi Gerald Lamaj si përfitues apo palë në marrëdhënie ekonomike me subjektet "Soft Log" sh.p.k, "Media Futurë" sh.p.k dhe "Im



Data” sh.p.k bazuar në ekstraktet bankare dhe financiare të administruara në fashikullin hetimor?

Përgjigje: Edhe në lidhje me këtë pyetje, jap të njëjtën përgjigje si më sipër. Nuk rezultoi që shtetasi Gerard Lamaj të ketë përfituar të ardhura nga subjektet “Soft Log” sh.p.k, “Media Futurë” sh.p.k dhe “Im Data” sh.p.k si dhe të ketë marrëdhënie ekonomike me subjektet “Soft Log” sh.p.k, “Media Futurë” sh.p.k dhe “Im Data” sh.p.k.

Sa më sipër shetasit Italian:

Paolo Palumbo i datelindjes 13.07.1998 me nr dokumenti AY4352912

Salvatore Solazzo i datelindjes 01.05.1993 me nr dokumenti AY4352862

Rosario Lazzarin i datelindjes 27.10.1978 me nr dokumenti AT4610426

Në cilësinë e administratoreve dhe aksionereve te vetem, jane perfitues perkatesisht te shumave 866.539 euro, 694.763 euro, 66.620 euro, te cilat kane kaluar ne llogarit e subjekteve tregtare SoftLog Shpk, Media Future Shpk dhe Im Data, shuma te cilat nuk jane kontabilizuar, sipas legjislacionit tatimore shqiptare, e provuar kjo, nga korespondencat me administraten tatimore dhe aktin e ekspertimit kontabel.

Gjithashtu vlen te theksohet se, në nenin 3 të Ligjit Nr.9754, datë 14.6.2007 “Për Përgjegjësinë Penale Të Personave Juridike” përcaktohet se: “Personi juridik ka përgjegjësi për vepra penale të kryera: a) në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij; b) në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik; c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik”.

Mbi këtë bazë, u shqyrtua në themel me gjykim të zakonshëm çështja penale me Nr. 9476, të vitit 2019, në ngarkim të të pandehurve **Paolo Palumbo, Rosario Lazzarin, Salvatore Solazzo dhe subjektet juridike “IM DATA” sh.p.k., “Media Future” sh.p.k., “SOFTLOG” sh.p.k.,** akuzuar për veprën penale të “**Fshehja e te ardhruave**”, parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal.

Vlerësimi i Gjykatës.

Përsa i përket **kualifikimit ligjor** të fakteve të parashtruara më sipër Gjykata vëren se, **neni 180/3 i K.Penal** parashikon:

Përsa i përket kualifikimit ligjor të fakteve të mësipërme, gjykata i referohet nenin **180/3 të Kodit Penal**, i cili parashikon:

“Fshehja apo shmangia nga pagimi e detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përlllogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kur kjo veprë kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se pesë milionë lekë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur kjo veprë kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se tetë milionë lekë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.”

Veprat penale për të cilën akuzohet ee pandehura është parashikuar nga Kodi Penal ne Pjesën e posacme të tij, në Kreun III, “*Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike*”

Seksioni VI të titulluar "Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet". Objekti i përgjithshëm i të gjithë këtyre figurave të veçanta krimi, që përfshihen në këtë seksion, e përbëjnë të njëjtat marrëdhënie shoqërore. E përbëjnë marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të taksave dhe tatimeve në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave ekonomike të saj nga çfarëdolloj veprimtarie që ka për qëllim shmangien nga pagimi në buxhetin e shtetit të detyrimeve fiskale.

Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale "Fshehje e të ardhurave", parashikuar nga neni 180/3 të Kodit Penal, Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Pra, ana objektive paraqet sulmin kriminal të shqyrtuar nga ana e tij e jashtme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual dhe konsekuent të ngjarjeve dhe fenomeneve, të cilat fillojnë të vihen në lëvizje me kryerjen nga subjekti i veprimit ose mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar kriminal. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: i) *veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm*; ii) *mënyra e kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e vepërës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe iii) *Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjenë rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

Në kuptim të nenit 180 të Kodit Penal, figura e veprës penale "Fshehja e të ardhurave" nga ana objektive krimi kryhet nëpërmjet fshehjes apo shmangies nga pagimi e detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, si dhe përmes përlllogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit.

Pra, element vendimtar i anës objektive i kësaj figure vepre penale është kundërligjshmëria. Gjykata vlerëson se, neni 180 i Kodit Penal është një dispozitë blankete, që të referon në dispozita të tjera ligjore, për të përcaktuar se, dokumentat dhe të dhënat e nevojshme që duhet të deklarohen në organet tatimore, me qëllim që këto të fundit të kenë mundësi të mbledhin detyrimet tatimore nga subjektet që ushtrojnë një biznes të caktuar.

Në këto kushte, gjykata çmon se, në rastin konkret duhet t'i referohet Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ku në nenin 2 të tij nën titullin "Fusha e veprimit" parashikohet shprehimisht se:

"Ky ligj zbatohet për: a) tatimpaguesit, administratën tatimore, agjentët tatimorë, agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, si dhe për persona të tjerë, të përcaktuar nga legjislacioni tatimor; b) personat e ngarkuar për të paguar, mbajtur, deklaruar dhe transferuar në Buxhetin e Shtetit kontributet, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; c) personat që paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, për sa u përket pagesës dhe mbledhjes së kontributeve; ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar."

Në nenin 5 të këtij ligji nën titullin "Përkufizime" parashikohet se:

"1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ...ç) "Kontribut" është detyrimi

monetar i detyrueshëm për t'u paguar si shpërblim për një shërbim specifik apo ushtrim të të drejtave, për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor të të punësuarve; ...ë) **"Tatim"** është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që nuk bëhet në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara; f) **"Taksë"** është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë. Dispozitat e këtij ligji për tatimet dhe detyrimet tatimore zbatohen njëjloj edhe për taksat; g) **"Tatimpagues"** është personi apo individi, i cili detyrohet nga ligji të paguajë tatime, taksa ose kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe agjenti i mbajtjes së tatimit në burim,..". Po ashtu në nenin 6 të këtij ligji nën titullin **"Detyrimi tatimor"** parashikohet se: "1. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor. 2. Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa, në formë të jashtëligjshme, apo bëhet zotërues i një sendi, në forma të jashtëligjshme. Kur personi bëhet zotërues i një sendi në forma të jashtëligjshme, ky detyrim përlllogaritjet për të gjithë periudhën në të cilën personi ka gëzuar frytet e kësaj pasurie. 3. Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjokat, për rastet e parashikuara nga ky ligj."

Në nenin 40 të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nën titullin **"Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare"** parashikohet shprehimisht se:

"1. Personat fizikë dhe juridikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". 2. Personat e regjistruar sipas këtij ligji pajisen me numër identifikimi unik, të gjeneruar elektronikisht, i cili shërben si numër i identifikimit tatimor të tyre, për tatimet kombëtare dhe vendore. 3. Afati për dorëzimin e aplikimit, formati i aplikimit dhe mënyrat e dorëzimit të aplikimit përcaktohen në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Dokumentet e kërkuara, si pjesë e aplikimit për qëllime tatimore, përcaktohen në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji. 4. Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit shërben njëkohësisht si regjistrim në administratën tatimore, si dhe në skemat e sigurimit shoqëror e shëndetësor të Inspektoratit të Punës dhe organeve doganore. 4.1. Në administratën tatimore regjistrohen personat juridikë, fizikë dhe individët e mëposhtëm: ...ç) të vetëpunësuarit në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant;... 5. Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore."

Në nenin 47 të këtij ligji nën titullin **"Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore për tatimpaguesit e klasifikuar "biznes i vogël"** parashikohet se:

"Tatimpaguesit, që janë subjekt i ligjit "Për taksën vendore të biznesit të vogël", për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe lëshojnë një faturë të thjeshtë tatimore apo kupona tatimorë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe dispozitat e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat".

Në nenin 48 të këtij ligji nën titullin **"Mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve të të dhënave tatimore"** parashikohet shprehimisht se:

"1. Regjistrat, librat dhe informacioni financiar janë dokumente, që përmbajnë informacionin e regjistruar, në mënyrë kronologjike dhe sistematike, të veprimeve tregtare të

tatimpaguesit, të cilat mbahen për përcaktimin e shumës së detyrimeve tatimore të këtij tatimpaguesi. 2. Të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga tatimpaguesi, për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentet. 3. Tatimpaguesi, për çdo shitje, lëshon faturë tatimore ose kupon tatimor.”.

Në nenin 64 të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” nën titullin “Deklarata tatimore” parashikohet se:

“1. Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor përkatës. 2. Kur ligji tatimor kërkon dorëzimin e deklaratës tatimore, tatimpaguesi bën vetëdeklarim të shumës së detyrimit tatimor apo të kontributit, pa prituri vlerësimin, njoftimin ose kërkesën nga administrata tatimore dhe e paguan këtë tatim në afatin dhe vendin e përcaktuar në ligjin tatimor përkatës, pavarësisht nga shtyrja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore.”.

Në nenin 131 të këtij ligji nën titullin “Veprat penale” parashikohet shprehimisht se:


“1. Personi, i cili, për çdo tatim të vendosur nga një ligj tatimor, kryen ndonjërin nga veprat që vijojnë, dënohet në përputhje me Kodin Penal kur: a) me dashje përpiqet të kryejë evazion tatimor; b) me dashje nuk mbledh tatimin ose nuk e paguan atë në buxhet; c) me dashje fsheh ose shkatërron libra dhe regjistrime, dokumente, deklaratat apo informacion tjetër të rëndësishëm për detyrimin tatimor; ç) me dashje dorëzon dokumente, deklaratat tatimore ose informacion të falsifikuar; d) me dashje nuk i bindet një kërkesë me shkrim për t’u paraqitur në organet tatimore; dh) me dashje ndërhyr në vlerësimin ose mbledhjen e tatimit; e) kërcënon ose kryen shkelje ndaj një zyrtari tatimor; ë) në bashkëpunim me një zyrtar tatimor, paguan ose pranon rryshfete; f) i ofron rryshfet një zyrtari tatimor; g) me dashje jep informacion tatimor në mënyrë të paautorizuar me ligj ose rregullore. 2. Administrata tatimore bën kallëzim penal në prokurori për çdo shkelje të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.”.

Në nenin 6 të Ligjit Nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” nën titullin “Detyrimet e personave që paguajnë kontributet” parashikohet se:

“1. Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur. 2. Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, se bashku me kontributet e punëdhënësit. 3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit dhe për punonjësit e papaguar të familjes.”. ndërsa në nenin 7 të këtij ligji parashikohet se: “Personat juridikë dhe fizikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Dy ditë pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, personi juridik dhe fizik duhet të deklarojë në organin tatimor listën e të punësuarve, me pagën përkatëse, përfshirë dhe listën e punonjësve të papaguar të familjes së personit fizik mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht. Organizatat jofitimprurëse, entet shtetërore, personat “i vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant”, si dhe “kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie” regjistrohen në administratën tatimore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Në nenin 10 të këtij ligji nën titullin “Detyrimi për të deklaruar” parashikohet se:

“1. Personi juridik dhe fizik i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë, në formë elektronike, në organin tatimor të dhënat e detyrimeve për kontributet në total dhe për çdo individ. 2. Personat juridikë dhe fizikë që janë të detyruar të paguajnë



kontribute deklarohen, në formë elektronike, në organin tatimor; të dhënat e detyrimeve për kontributet, sipas deklaratës përkatëse, ku, përveç të tjerave, deklarohet për çdo person emri e mbiemri, numri personal, paga, shuma për t'u paguar e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, si dhe e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi. 3. Forma, përmbajtja dhe rregullat e deklarimit, në organet tatimore, të kontributeve dhe ndryshimit të numrit të punonjësve, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”,

Në nenin 11 të këtij ligji nën titullin “Afatet e deklarimit dhe të pagesës” parashikohet se:

“1. Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme: ...b) nga personat fizikë, përjashtuar personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes si dhe të punësuarit.”.

Në nenin 4 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, në titullin “Burimi i të ardhurave” parashikohet se:

“Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon: a) Të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë; b) të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë; c) të ardhurat nga veprimtaria e zhvilluar nga një person jorezident, nëpërmjet një personi me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; d) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; dh) të ardhurat nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat nga të drejta të tjera, që rrjedhin nga pronësia mbi sendet e paluajtshme, në rast se këto sende ndodhen në territorin Republikës së Shqipërisë;..”

Në nenin 33 të këtij ligji nën titullin “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” parashikohet shprehimisht se:

“1. Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jo-fitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10 për qind nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë: a) dividendët; b) ndarjet e fitimit; c) interesat; ç) pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale; d) pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit; dh) pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues; e) pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikqyrëse që lidhen me to; ë) pagesat për qerata; f) pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre; g) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë. 2. Pika 1 e këtij Neni nuk zbatohet për: a. personat rezidentë shqiptarë, të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi fitimin dhe të tatimit mbi vlerën e shtuar ose personat e regjistruar sitatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël; b. dividendët dhe shpërndarjet e tjera të fitimit brenda objektit të përcaktuar në nenin 26 të ligjit; c. pagesat e bëra personave jorezidentë për shërbimet për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve dhe mallrave. 3. Përveç rasteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, tatimi në burim i mbajtur mbi pagesën, sipas pikës 1 të këtij neni, përfaqëson detyrimin tatimor përfundimtar.”.

Nga përmbajtja e kuadrit ligjor në fuqi rezulton se mosregjistrimi në organet tatimore të personave fizik ose juridik që ushtrojnë aktivitet privat sjellë këto pasoja: së pari, bën që

tatimpaguesi të mos mbaj regjistrat, librat që janë dokumente që përmbajnë informacionin e regjistruar, në mënyrë kronologjike dhe sistematike, të veprimeve tregtare të tatimpaguesit, të cilat mbahen për përcaktimin e shumës së detyrimeve tatimore të këtij tatimpaguesi nga organet tatimore. *Së dyti*, tatimpaguesi i pa regjistruar i shmanget bërjes së deklaratës tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor. *Së treti*, tatimpaguesi qoftë ky dhe i vetëpunësuar duke mos u regjistruar si biznes i shmanget bërjes së deklaratës së pagimit të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore. Pra, mosregjistrimi i një biznesi në QKR shoqërohet me mosdeklarimin e të dhënave të nevojshme sipas legjislacionin tatimor, që do të shërbenin organeve tatimore për përcaktimin e shumës së detyrimit tatimor dhe vjeljen e këtyre detyrimeve, përfshi këtu dhe kontributet shoqërore e shëndetësore.

Nga ana objektive, duhet që të pandehurit me veprime ose mosveprime të kundraligjshme të ketë fshehur, të jetë shmangur nga pagimi i detyrimeve tatimore nëpërmjet dorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi; të ketë dorëzuar dokumenta të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim përfitimi material, për vete apo për të tjerët, përmes përlllogaritjes së pasaktë të shumës së tatimi, taksës, apo kontributit. Per te patur vepren penale te parashikuar nga neni 180 i K.Penal duhet qe të ketë kaluar afati i përcaktuar me ligj apo me marrëveshje mes subjektit tatim-pagues dhe organit kompetent shtetëror për vjeljen e këtij detyrimi tatimor apo takse. Subjekti tatimpagues të kete objektivisht mundesi per pagimin e detyrimit te percaktuar nga organi tatimor.

Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, Gjykata çmon se **provohet përtej çdo dyshimi se të pandehurit Paolo Palumbo, Rosario Lazzarin, Salvatore Solazzo dhe subjektet juridike "IM DATA" sh.p.k., "Media Future" sh.p.k., "SOFTLOG" sh.p.k.e kanë konsumuar figurën e veprës penale "Fshehja e të ardhurave" parashikuar nga neni 180/3 i Kodit Penal.**

Të pandehurit, shtetas italian Salvatore Solazzo, Rosario Lazzarin dhe Paolo Palumbo, ne cilesine e administratoreve dhe aksionereve te vetem të shoqërive tregtare të regjistruara prane Qkb, jane perfitues perkatesisht te shumave 866.539 euro, 694.763 euro, 66.620 euro, te cilat kane kaluar ne llogarite e subjekteve tregtare SoftLog Shpk, Media Future Shpk dhe Im Data, shuma te cilat nuk jane kontabilizuar, sipas legjislacionit tatimore shqiptar, e provuar kjo nga korespondencat me administraten tatimore dhe aktine ekspertimit kontabel.

Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "Fshehje e të ardhurave", parashikuar nga neni 180 te Kodit Penal, Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Ana subjektive karakterizohet nga dy elementë përbërës: Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale "*nullum crimen, nulla poena sine culpa*". Ky element i përgjegjësise penale parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal, ku thuhet: "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quket me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*" Pra, faji si element i domosdoshëm i përgjegjësise penale përmban në vetvete dy moment: *atë intelektual* dhe *atë që lidhet me vullnetin*. ~~Momenti~~ intelektual tregon nëse subjekti nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm të veprës, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave të dëmshme, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim të kundraligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës. Në vartësi nga karakteri i këtyre dy momenteve, intelektual dhe volutiv, është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë.

Gjykata vlerëson se, figura e veprës penale "**Fshehje e të ardhurave**", parashikuar nga neni

180 te Kodit Penal kërkon si formë faji dashjen e drejtëpërdrejtë dhe për motive të përfitimit personal. Gjithashtu, gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Prandaj, për të përcaktuar anën subjektive në çështjen objekt gjykimi, gjykata do të analizojë veprimet e të pandehurve. Në rastin konkret, provohet përtej çdo dyshimi, se të pandehurit të kenë vepruar me dashje e drejtëpërdrejtë dhe për motive të përfitimit personal.

Në lidhje me subjektin e veprës penale, Gjykata çmon se, në rastin konkret, të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale ka qënë mbi 18 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se të pandehurit Paolo Palumbo, Salvatore Solazzo dhe Rosario Lazzarin kanë mbushur moshën për përgjegjesi penale janë të përgjegjshem para ligjit.

Ndërsa personat juridik, subjekti Media Future, sh.p.k, me NIPT L91521009H, subjekti Soft Log shpk, NIPT L811904031F dhe subjekti Im Data shpk, me MIPT L81630006H, kanë përgjegjësi penale në bazë të nenit 3 të Ligjit Nr.9754, datë 14.6.2007 "Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridike" përcaktohet se: **"Personi juridik ka përgjegjësi për vepra penale të kryera: a) në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij; b) në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik; c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik"**.

Sa më sipër u arsyetua, Gjykata vlerëson se nga mbi bazën e provave të administruara rezulton se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se të pandehurit e kanë konsumuar figurën e veprës penale për të cilën akuzohen. Gjithashtu, Gjykata çmon se cilësimi juridik i bërë faktit penal nga prokurori është i drejtë.

Akuza ne ngarkim të të pandehurve është provuar në seancë gjyqësore me administrimin e provave në seancë gjyqësore me gjykim të zakonshëm.

Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Gjykata para se të disponojë me dënimin penal, duhet të ketë parasysh parimet dhe kriteret e përgjithshme të caktimit të dënimit.

Gjykata vlerëson se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale nga njëra anë dhe shkallës së fajit të autorit të saj nga ana tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se individualizimi i llojeve të dënimeve, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar gjithë elementët juridikë të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Kështu, neni 47 i tij, nën titullin "Mënyra e caktimit të dënimit", parashikon se **"Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese."** Në këtë dispozitë është shprehur parimi i individualizimit të dënimit, i cili është një nga parimet themelore që udhëheq gjykatën në caktimin e dënimit. Kjo është arsyeja pse ligjvënësi për çdo vepër penale të veçantë ka parashikuar marzhet minimum dhe maksimum për dënimin e veprës penale. Pikërisht ky limit do të jetë hapësira e gjykatës për të vlerësuar masën e dënimit.

Një nga kriteret që mban parasysh gjykata në caktimin e dënimit është rrezikshmëria e vepres penale, e cila përcaktohet nga këto element, që janë: a) Objekti; b) Vendi; c) Koha; d) Gjendja

në të cilën kryhet vepra penale; e) Nëse vepra penale është e përhapur në atë rreth; f) Rrethanat që kanë ndikuar në kryerjen e saj.

Në lidhje me rrezikshmërinë e figurës së veprës penale. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Gjykata thekson se kjo vepër përbën krim dhe paraqet rrezikshmëri relativisht të lartë shoqërore, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimet *e përshkruara më lart*. Pra, rrezikshmëria shoqërore e kësaj vepre, në kushtet aktuale është e lartë duke parë tendencat e rritjes së kësaj vepre penale, jo vetëm në gjithë territorin e Republikën së Shqipërisë, por edhe përhapjen e kësaj vepre penale në rrethin e Tiranës. Prandaj, në caktimin e dënimit gjykata duhet të ketë parasysh funksionin e parandalimit të përgjithshëm në kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjithashtu, për interpretimin e “rrezikshmërisë së autorit të saj” Gjykata ka parasyshë disa elementë të tjerë si: a) Gjendja sociale; b) Profesion; c) Arsimimi; d) Gjendja familjare; e) Gjendja gjyqësore. Interpretuar në harmoni të gjithë këto rrethana objektive dhe subjektive që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me personalitetin dhe individualitetin që paraqet individi në shoqërinë tonë, japin konkluzionin se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të ulët ose të lartë. Prandaj, për gjykatën lind detyrimi që në çdo çështje të analizojë faktorët apo tiparet e personalitetit të autorit të veprës penale. Kjo për faktin, pasi për arritjen e qëllimit të parandalimit të posaçëm është e nevojshme që dënimi t’i përshtatet personalitetit të fajtorit d.m.th t’i përshtates tërësisë së karakteristikave individuale të tij, që përbëjnë fizionominë e tij politiko shoqërore. I pandehuri nuk është dhe nuk mund të shikohet si figurë abstrakte, por si një njeri i gjallë me cilësi të caktuara, me një të kaluar dhe me një prespektivë të caktuar. Sipas të drejtës tonë penale vepra penale përbën një unitet të elementëve objektiv dhe subjektivë dhe në shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës influencojnë në shumë raste rrethanat që karakterizojnë të pandehurin, cilësitë e subjektit të krimit.

Zhvillimi mendor, karakteri dhe gjendja e ndërgjegjes së autorit kanë rëndësi për trajtimin penal të saj. Në çmuarjen e personalitetit të të pandehurit duhet të merret parasysh mosha si tregues kryesor i pjekurisë mendore, sjellja e tij e mëparshme, sjellja pas kryerjes së veprës penale, pendimi dhe gadishmëria për të riparuar pasojat e veprës penale. Gjithashtu, duke u nisur nga këto tipare, duhet konstatuar se çfarë përfaqëson për të pandehurin vepra penale që ai ka kryer, është ajo pasojë llogjike e botkuptimit, karakterit dhe prirjeve apo ajo nuk përfaqëson thelbin e cilësive dhe tipareve të tij, por është një akt i pamenduar mirë, një reagim në rrethana konkrete të rastit. Prandaj, në çdo çështje konkrete, gjykata, duhet të hetojë lidhur me personalitetin e të gjykuarit. Kjo për faktin pasi mënyra e reagimit të autorëve ndaj dënimit ose ndikimi që mund të ushtrohet mbi këtë me anë të dënimit është i ndryshëm.

Shkallën e fajit. Në lidhje me këtë kriter, nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurve, Gjykata thekson se ato janë kryer në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit, pasi ata kanë parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tyre dhe kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme.

Në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në caktimin e masës së dënimit kundër autorit të veprës penale penale konkrete, gjykata mban parasysh, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektivë që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të fajtorit.

Duke qenë se të pandehurit u deklaruan fajtor dhe u dënuan për veprat penale për të cilën akuzohen, bazuar në nenet 393 e 485 të K.Pr.Penale, të pandehurit detyrohen të paguajë shpenzimet proceduriale të kryera në fazën e hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet

gjyqësore në mënyrë solidare.

PER KETO ARSYE:

Gjykata bazuar të nenet 384, 390 te Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI:

- 1) Deklarimin fajtor të të pandehurit **Paolo Palumbo** për veprën penale **“Fshehja e të ardhurave”**, parashikuar nga **neni 180/3** i Kodit Penal dënimin e tij me **5 (pesë) vjet burgim**.
- 2) Deklarimin fajtor të të pandehurit **Rosario Lazzarin** për veprën penale **“Fshehja e të ardhurave”**, parashikuar nga **neni 180/3** i Kodit Penal dënimin e tij me **5 (pesë) vjet burgim**.
- 3) Deklarimin fajtor të të pandehurit **Salvatore Solazzo** për veprën penale **“Fshehja e të ardhurave”**, parashikuar nga **neni 180/3** i Kodit Penal dënimin e tij me **5 (pesë) vjet burgim**.
- 4) Vuajtja e dënimit u fillon të pandehureve, nga dita e ekzekutimit te ketij vendimi dhe të kryhet ne nje burg te sigurise se zakonshme.
- 5) Deklarimin fajtor të të pandehurit **“IM DATA” sh.p.k.** për veprën penale **“Fshehja e të ardhurave”**, parashikuar nga **neni 180/3** i Kodit Penal dënimin e tij me **mbarimin e personit juridik**
- 6) Deklarimin fajtor të të pandehurit **“Media Future” sh.p.k.** për veprën penale **“Fshehja e të ardhurave”**, parashikuar nga **neni 180/3** i Kodit Penal dënimin e tij me **mbarimin e personit juridik**
- 7) Deklarimin fajtor të të pandehurit **“SOFTLOG” sh.p.k.** për veprën penale **“Fshehja e të ardhurave”**, parashikuar nga **neni 180/3** i Kodit Penal dënimin e tij me **mbarimin e personit juridik**
- 8) Shpenzimet e kryera gjatë hetimeve paraprakë dhe ato gjyqësore në ngarkim të të pandehurit.
- 9) Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke filluar nga e nesërmyja e njoftimit te ketij vendimi në Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall në Tirane sot me datë 04.04.2022.

SEKRETAR

REI PEÇI



Shpenzime gjyqësore

Shpenzime procedurale te prokurorise

58 000 Leke.

GJYQATAR

LAZER SALLAKU



Vendimi mori forme te prere pasi nuk u ankimua me dt **20.06.2022**
Tirane me dt **23.06.2022**

K / SEKRETAR

MIMOZA TAFI



Shpenzime te gjykimit ne seance paraprake 6750 Leke.

Shpenzime te gjykimit ne themel

Njoftime 4 cope 600 Leke.

Avokat kryesisht Rabije Cenalia 5000 Leke.

Avokat kryesisht Gezime Buci 5000 Leke.

Avokat kryesisht Edvis Gorishti 5000 Leke.

